**KËRKESË**
**Nr. 1073, datë 11.11.2025**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion trotuari perimetral shkolla 9-vjeçare 'Ndre Mjeda'".

Subjekti kërkues i këtij projekti është: Bashkia Shkodër

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "truall", bazuar në Vendimin nr. 89, datë 3.2.2016 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", dhe pasuritë e llojit "ndërtesë jo-banimi" përllogaritur në bazë të VKM Nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e proçedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Shkodër, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 1,749,932.10 lekë (një milion e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy pikë dhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
**Ermal Shena**

# LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “RIKONSTRUKSION TROTUARI PERIMETRAL SHKOLLA 9- VJEÇARE ‘NDRE MJEDA’”

| Nr | **PRONARI** | | | **TË DHËNA KADASTRALE** | | | | | | | | | **VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | **Truall** | | | **Ndertesë social ekonomike** | | | **VLERA TOTALE (lekë)** | **SHËNIME (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)** |
| | **Emri** | **Atësia** | **Mbiemri** | **Qyteti** | **Z. kadastrale** | **Indeksi i hartes** | **Nr. pasurise** | **Lloji i pasurise** | **Siperfaqja totale ($m^2$)** | **Truall( $m^2$)** | **Volumi** | **Faqe** | **Siperfaqja ($m^2$)** | **Çmimi (lekë/$m^2$)** | **Vlera (lekë)** | **Siperfaqja ($m^2$)** | **Çmimi (lekë/$m^2$)** | **Vlera (lekë)** | | |
| | **A** | **B** | **C** | **Ç** | **D** | **E** | **F** | | **G** | **H** | **I** | **J** | **K** | **L** | **M** | **N** | **O** | **P** | **Q** | **R** |
| 1 | REMZI | EJUP | ZENELI | Shkoder | 8591 | N-6 | 1/701 | TRUALL | 55.1 | 55.1 | 22 | 217 | 55.1 | 8511 | 468,956.10 | 49.92 | 0 | 1,280,976 | 1,749,932.10 | Në seksionin “E”, të Kartelës së Pasurisë së Paluatjshme, pasqyrohet shënimi: “Korrigjim hartografik i spërfaqes dhe i numrit të pasurisë sipas referencës 011406, leje legalizimi nr. 3314, datë 21.7.2010, godinë socio-ekonomike 1-katëshe”. |
| 2 | SHTET | | | Shkoder | 8591 | N-6 | 1/512 | TROTUAR | 256.82 | 256.82 | 22 | 213 | 119 | 8511 | - | 0 | 0 | - | - | Në seksionin “E”, të Kartelës së Pasurisë së Paluatjshme, pasqyrohet shënimi: “Korigjim hartografik dhe sipërfaqes sipas references 011406”. |
| 3 | SHTET | | | Shkoder | 8591 | N-6 | 1/1080 | SHESH | 8047.6 | 8047.6 | 9 | 49 | 20 | 8511 | - | 0 | 0 | - | - | Në seksionin “C”, të Kartelës së Pasurisë së Paluajtshme, pasqyrohet referenca 00017714, datë 9.5.2017: “Mbi këtë pasuri bie pasuria e llojit ndërtesë me nr 1/852/2, regjistruar në volum 56, f. 230. |
| | **TOTALI** | | | | | | | | **8359.52** | | | | **194** | | **468,956** | **49.92** | | **1,280,976** | **1,749,932.10** | |